

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7962
E shtunë, 28 dhjetor 2024
Çmimi 0.50 €

Konfirmohet rasti i parë
me linë e majmunëve
në Kosovë | FQA 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE



**SHKUP: PARTITË SHQIPTARE
VAZHDOJNË PËRPLASJET RRETH
LIGJIT PËR GJUHËT** F. 3

**MBYLLET EDHE NJË INSTITUCION
PARALEL NË VERI TË KOSOVËS** F. 6

**300 EURO PËR 50 METRA KATRORE:
FATURAT E 'TERMOKOS'-IT
'NGRIJNË' PRISHTINASIT** F. 4

EKONOMI



**BQK-JA LANSOI PLATFORMËN PËR
KRAHASIMIN E PRODUKTEVE DHE
SHËRBIMEVE FINANCIARE** F. 8

**LIMAJ: SHUMAT MARRAMENDËSE TË
PAGUARA PËR IMPORT TË
ENERGJISË, FYTYRA E VËRTETË E
KËSAJ QEVERIE** F. 8

SPORT



**NË FUNDJAVË ZHVILLOHET XHIROJA
E FUNDIT PËR VITIN 2024** F. 10

HOVENIERI NË PARAQITJEN E FUNDIT PËR LARGIMIT: MEZI PRES TË SHOH ÇFARË DO TË ARRINI NË VITIN 2025



Ambasadori amerikan Jeff Hovenier ka bërë paraqitjen e tij të fundit përpara se të largohet nga Kosova. Hovenieri ka thënë se ky dhjetor shënon edhe fundin e

shërbimit të tij si ambasador i ShBA-së. Ai e ka falënderuar popullin e Kosovës për miqësinë dhe mikpritjen, duke shtuar se ka qenë nder për të që ka shërbyer në rolin e

përfaqësuesit diplomatik amerikan. Ambasadori amerikan ka thënë se mezi pret të shohë se çfarë populli i Kosovës do të arrijë në vitin 2025 dhe më tej

**MBI 90 000
PERSONA TË
REGJISTRUAR
PËR VOTIM
NGA DIASPORA** F. 8



**AUTORITETET
ENERGJETIKE:
S'KA MUNGESË
TË RRYMËS, POR
MBINGARKESË
TË RRJETIT** F. 7



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Presidenti gjerman shpërndan Parlamentin, cakton zgjedhjet për 23 shkurt

BERLIN, 27 PRILL - Presidenti i Gjermanisë, Frank-Walter Steinmeier, ka urdhëruar shpërndarjen e Parlamentit dhe ka caktuar zgjedhjet e reja për 23 shkurt. Zgjedhjet e reja do të mbahen pas rënies së koalicionit qeverisës të kancelarit Olaf Scholz. Scholz nuk e mori votëbesimin më 16 dhjetor dhe aktualisht po udhëheq një qeveri të pakicës, pasi koalicioni trepartiak i tij kolapsoi më 6 nëntor. Kjo ndodhi për shkak se Scholzi shkarkoi ministrin e tij të Financave lidhur me mospajtimet se si të revitalizohet ekonomia e Gjermanisë. Steinmeieri tha se e mori vendimin për zgjedhjet e

reja për shkak se, pas konsultimeve me udhëheqësit partiakë, u bë e qartë se nuk ka marrëveshje mes partive politike të Gjermanisë për një qeveri të re me përbërjen aktuale të Parlamentit. "Pikërisht në momente të vështira kërkohet stabilitet dhe një qeveri e aftë që të marrë veprime dhe një shumicë e besueshme në Parlament", tha ai. "Prandaj, jam i bindur se për të mirën e shtetit tonë, zgjedhjet e reja janë rruga e duhur", shtoi presidenti gjerman. Pasi që Kushtetuta gjermane, e miratuar pas Luftës së Dytë Botërore, nuk lejon që Bundestagu ta shpërndajë veten, ishte në dorën e



Steinmeierit të vendoste për një gjë të tillë dhe të shpallte zgjedhjet e reja. Ai kishte 21 ditë afat për këtë vendim. Pas shpërndarjes së Parlamentit, sipas ligjeve

gjermane, zgjedhjet duhet të mbahen brenda 60 ditësh. Paraprakisht, udhëheqësit e partive kryesore në Gjermani ishin pajtuar për datën 23 shkurt. Zgjedhjet në Gjermani do të mbahen shtatë muaj më herët seç ishin planifikuar fillimisht. Steinmeieri paralajmëroi për ndërhyrje nga jashtë në votime, duke thënë se është "një rrezik për demokracinë, qoftë nëse është i fshehtë, siç ishte në rastin për zgjedhjet e fundit në Rumani, apo i hapur, ashtu siç po ndodh gjithnjë e më shumë në platformën X". Gjykata Kushtetuese ka anuluar raundin e parë të zgjedhjeve presidenciale në Rumani, pasi

u publikuan pretendime se Rusia kishte koordinuar një fushatë online për të promovuar një kandidat të krahut të djathtë, që fitoi raundin e parë. Fushata në Gjermani veçse ka nisur. Sipas sondazheve, partia e Scholzit është në garë të ngushtë me bllokun opozitar të udhëhequr nga Friedrich Merz. Ndërkaq, të Gjellbërit - partnerët aktualë qeverisës të Scholzit - po ashtu vlerësohen se do të jenë në garë për të marrë poste kyçe. Megjithatë, sondazhet sugjerojnë se qeveria e re me gjasë do të udhëhiqet nga Merz si kancelar, në një koalicion me të paktën një parti tjetër.

Azerbajxhan, avioni u rrëzua për shkak të "një objekti të jashtëm"

AKTAU, 27 DHJETOR - Kompania ajrore e Azerbajxhanit ka njoftuar se përfundimet paraprake tregojnë se avioni i saj u rrëzua si pasojë e "një objekti të jashtëm fizik dhe teknik", ndërkohë që burimet në dijeni të rezultateve të hetimeve, thanë se avioni u godit nga sistemet mbrojtëse ajrore të Rusisë. Zyrtarët rusë thanë se avioni ndryshoi drejtim për shkak të mjegullës dhe pas paralajmërimit për aktivitetin e një droni ukrainas në atë zonë. Ekspertët fajësuan sistemet mbrojtëse ajrore ruse për rrëzimin e avionit që shkaktoi vdekjen e 38 personave dhe lëndimin e 29 të mbijetuarve. Dy udhëtarë të këtij aeroplani, që i mbijetuan rrëzimit, thanë se dëgjuan të paktën një krismë të zhurmshme ndërkohë që avioni po i afrohej Groznit, në pjesën jugore të Rusisë. "Pas kësaj krisme, më dukej që aeroplani do të copëtohej. Ishte e qartë që aeroplani ishte dëmtuar... Nuk dukej njësoj",

tha i mbijetuari Subhonkul Rakhimov nga spitali. Pamjet e regjistruara në avion para rrëzimit tregojnë maskat e varura të oksigjenit dhe udhëtarët e veshur me jelekë. Pas rrëzimit të tij, në video-regjistrime shihen udhëtarët e lënduar teksa dalin nga aeroplani. Rrëzimi i aeroplanit hodhi dritë mbi rreziqet ndaj avionëve civilë edhe atëherë kur fluturojnë qindra kilometra larg një zone lufte, veçanërisht kur luftohet me dronë. Avioni i kompanisë 'Azerbaijan Airlines' po fluturonte nga kryeqyteti Baku drejt Groznit të mërkurën, kur ndryshoi drejtim për shkak ende të panjohura dhe u përplas ndërkohë që po përpiqej të ulej në Aktau të Kazakistanit pasi që kishte fluturuar mbi pjesën lindore të Detit Kaspik. Agjencia ruse për mbikëqyrjen e aviacionit tha të premtën se aeroplani, që u rrëzua në Kazakistan të mërkurën, vendosi ta ndryshonte

drejtimin e planifikuar për shkak të mjegullës dhe paralajmërimeve nga autoritetet vendase për aktivitete të dronëve ukrainas në atë zonë. "Është e domosdoshme të identifikohen të gjitha rrethanat e këtij incidenti. Situata përreth aeroportit të Groznit atë ditë dhe gjatë atyre orëve ishte mjaft e vështirë. Dronët luftarakë të Ukrainës po kryenin sulme terroriste ndaj infrastrukturës civile në Grozni dhe Vladikavkaz... Po ashtu, kishte mjegull të dendur në afërsi të aeroportit të Groznit", tha drejtuesi i Agjencisë ruse për transportin ajror, Dmitry Yarov. Ekspertët e aviacionit vlerësojnë se aeroplani i kompanisë ajrore të Azerbajxhanit që u përplas në Kazakistan ka shumë gjasa të jetë rrëzuar pasi është goditur nga sistemet ruse të mbrojtjes ajrore. Sipas tyre, vrimat në pjesën e pasme të avionit janë shenjë se ai mund të jetë



goditur nga sistemet mbrojtëse ajrore të Rusisë, që po përpiqeshin ta parandalonin sulmin e një droni ukrainas. "Gjasat janë të mëdha që përfundimi që ka nxjerrë qeveria e Azerbajxhanit të jetë i saktë, që sistemi mbrojtës ajror rus ka gabuar në identifikimin e avionit ngaqë ai ka ndryshuar drejtim dhe se ka reaguar me sistemin e mbrojtjes ajrore për shkak të sulmeve të dronëve ukrainas nga ky drejtim. Ka

mundësi që ata e ngatërruan aeroplanin e udhëtarëve me një dron ukrainas dhe reagues me sistemet e mbrojtjes ajrore", thotë ekspertja e Rusisë, Ann Marie Dailey nga 'Rand Corporation'. Kompania ajrore e Azerbajxhanit pezulloi të premtën fluturimit për në shtatë qytete ruse, ndonëse do t'i vazhdojë fluturimet drejt gjashtë qyteteve kryesore të Rusisë.

Sonda e NASA-s dërgon sinjal pas misionit afër Diellit



WASHINGTON, 27 DHJETOR - Agjencia hapësinore e Shteteve të Bashkuara (NASA) tha se sonda e saj diellore, Parker, është "e sigurt" dhe po operon normalisht në afrimin më të afërt me Diellin të bërë nga ndonjë objekt i ndërtuar nga njeriu. Ajo kosmike kaloi vetëm 6.1 milionë kilometra nga sipërfaqja diellore më 24 dhjetor, duke fluturuar në atmosferën e jashtme të Diellit, të quajtur

korona, në misionin që synon t'i ndihmojë shkencëtarët që të mësojnë më shumë për yllin më të afërt me Tokën. Agjencia tha se ekipi i operacioneve në Laboratorin për Fizikë të Aplikuar të 'Johns Hopkins' ka pranuar një sinjal nga sonda pak para mesnatës të enjten. Ajo kosmike pritet të dërgojë të dhëna të detajuara telemetrike për gjendjen e saj më 1 janar,

shtoi NASA. Duke lëvizur me një shpejtësi prej 692.000 kilometrash në orë, anija kosmike duroi temperatura deri në 982 gradë celsius, sipas uebfaqes së NASA-s. "Në studimin nga afër të Diellit sondës Parker i mundësohet të bëjë matje që do të ndihmojnë shkencëtarët të kuptojnë më mirë se si materiali në këtë rajon nxehtë në miliona gradë, ta gjurmojnë origjinën e erës

diellore [një rrjedhje e vazhdueshme e materialit që ikën nga Dielli] dhe të zbulojë se si grimcat energjetike përshpejtohen në shpejtësi pothuajse të dritës", shtoi NASA. Sonda Parker u lansua më 2018 dhe gradualisht po rrotullohet më afër Diellit, duke përdorur rrotullimet e Venerës për t'u tërhequr në mënyrë gravitacionale në një orbitë më të ngushtë me Diellin.

Mbi 90 000 persona të regjistruar për votim nga diaspora

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 27 DHJETOR - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka bërë me dije se në mesnatë ka përfunduar procesi i regjistrimit të votuesve jashtë Kosovës. "Sipas të dhënave preliminare, numri i shtetasve të Kosovës që janë regjistruar votues jashtë Kosovës në periudhën 29 gusht - 26 dhjetor 2024, deri në orën 23:59, është 90 860, ndërkaq numri i aplikimeve që janë në shqyrtim është 18 244", ka njoftuar zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi.

Elezi ka bërë me dije se shqyrtimi i aplikimeve të pranuar do të vazhdojë edhe gjatë 27 dhjetorit dhe më pas KQZ-ja do të ketë një raport përfundimtar për numrin e qytetarëve të Kosovës të regjistruar për të votuar nga jashtë vendit.

Më 26 dhjetor partia në pushtet Lëvizja Vetëvendosje tha se

synonte që ta zgjaste periudhën e regjistrimit të votuesve jashtë Kosovës deri të dielën, por mbledhja e KQZ-së dështoi për shkak se në të nuk morën pjesë përfaqësuesit e partive opozitare.

Kosova do t'i mbajë zgjedhjet e rregullta parlamentare më 9 shkurt 2025.

Në këto zgjedhje shtetasit e Kosovës jashtë vendit do të mund të votojnë edhe në ambasada dhe konsullata të Kosovës.

Më herët gjatë dhjetorit, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, njoftoi se do të jenë 22 kuti postare në 22 shtete të ndryshme ku pjesëtarët e diasporës do të mund të votojnë. Ndërkaq, votimi fizik do të organizohet në 35 përfaqësi diplomatike dhe konsullore në 22 shtete.

Diaspora e Kosovës është e përqendruar kryesisht në Gjermani, Zvicër, Austri dhe vende të tjera të Evropës.

Në regjistrimin e fundit të



popullsisë për herë të parë janë përfshirë edhe shtetasit e Kosovës që jetojnë në diasporë dhe, sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, ata janë rreth 550 000 persona.

Zgjedhjet e 9 shkurtit do të jenë zgjedhjet e para të rregullta parlamentare që do të organizohen në Kosovë që nga shpallja e pavarësisë më 2008.

Ku do të mund të votojë mërgata e Kosovës?

Qendrat e votimit në përfaqësi diplomatike të Kosovës për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, që mbahen më 9

shkurt 2025, sipas Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, janë në këto shtete: Australi, Austri, Belgjikë, Çeki, Danimarkë, Francë, Gjermani, Holandë, Hungari, Itali, Kanada, Kroaci, Mal të Zi, Maqedoni të Veriut, Mbretëri të Bashkuar, Norvegji, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Shqipëri, Slloveni, Suedi, Turqi, Zvicër.

Shkup: Partitë shqiptare vazhdojnë përplasjet rreth Ligjit për Gjuhët

SHKUP, 27 DHJETOR - Deputetët e Frontit Evropian në opozitë, të udhëhequr nga Bashkimi Demokratik për Integritim (BDI), kanë reaguar ndaj deklaratës së kryetarit të Kuvendit, Afrim Gashi, i cili të enjten mbrëma tha se "gjuha maqedonase është gjuha e vetme zyrtare në Maqedoninë e Veriut".

Në një konferencë shtypi përpara Kuvendit, koalicioni deklaroi se pohimi i Gashit "përbën një gënjeshtëri të hapur dhe një tradhti të rëndë ndaj popullit shqiptar". "Është tronditëse, por jo e habitshme, që z. Gashi, si një person i përzgjedhur për të shërbyer si kukull në hierarkinë më të lartë të shtetit, ka rënë kaq poshtë, duke arritur nivele vetëposhtërimi që as antishqiptarët më të zjarrtë nuk kanë guxuar t'i prekin. Ky akt i turpshëm nënshtrimi dhe tradhtie tregon mungesën e tij të integritetit, por edhe gatishmërinë për t'i minuar parimet kushtetuese të këtij shteti", deklaroi më 27 dhjetor Arbana Pasholli, deputete nga radhët e Frontit Evropian.

Gashi, gjatë një debati në televizionin "Alsat", tha se gjuha shqipe nuk është gjuhë zyrtare, por në përdorim zyrtar, dhe se njëjta, siç shtoi Gashi, "është gjuhë e përkthyer".

Qëndrimin të Gashit në mbrojtje i doli edhe një nga liderët e koalicionit shqiptar VLEN, pjesë e qeverisë maqedonase, Arben Taravari, njëherësh ministër i Shëndetësisë, i cili deklaroi të njëjtën. "Ne mund të kemi lojëra fjalësh sa të duam. Gjuha shqipe nuk është e barabartë me gjuhën maqedonase. Këtu



pajtohemi të gjithë. Para vitit 1991, para pavarësisë, gjuhë zyrtare në Maqedoni [të Veriut], sipas Kushtetutës kanë qenë gjuha maqedonase, shqipe dhe turke. Tash është gjuha maqedonase dhe 20 % të popullatës që e flasin gjuhën shqipe. Kështu që, ne duhet të punojmë në këtë drejtim, dhe a do të themi se a është zyrtare apo jo, është kështu ose ashtu, nuk është e barabartë. Ne duhet të insistojmë, edhe të mundohemi që gjuha shqipe të qëndron si fjalë, jo si përqindje", tha Taravari të premtën përpara gazetarëve.

Megjithatë, nga Fronti Evropian rikujtuan amendamentin e pestë të Kushtetutës së Maqedonisë së Veriut. "Le t'i kujtojmë zotit Gashi disa fakte të pakundërshtueshme: Amendamenti i pestë përcakton qartë gjuhën shqipe, si gjuhë zyrtare, krahas gjuhës

maqedonase. Ligji për Përdorimin e Gjuhëve e konsolidon më tej përdorimin e gjuhës shqipe si zyrtare në të gjitha sferat e jetës publike", shtoi Pasholli.

Çfarë thotë amendamenti i pestë?

Në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë dhe në marrëdhëniet e saj ndërkombëtare, gjuhë zyrtare është gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik. Gjuhë tjetër që e flasin së paku 20 % e qytetarëve (gjuha shqipe), gjithashtu, është gjuhë zyrtare dhe alfabeti i saj, siç është përcaktuar me këtë nen.

Dokumentet personale të qytetarëve, të cilët flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase, lëshohen në gjuhën maqedonase dhe

alfabetin e saj, si dhe në atë gjuhë dhe alfabetin e saj, në përputhje me ligjin.

Ligji për Përdorimin e Gjuhëve, i cili ka qenë në qendër të diskutimeve gjatë viteve të fundit, është miratuar në vitin 2018 dhe ka hyrë në fuqi në vitin 2019. Ky ligj përbëhet nga 25 nene dhe ndryshimet kryesore që solli ishin: përdorimi i gjuhës shqipe edhe në procese gjyqësore, në bankënota dhe në uniforma policore.

Partia e kryeministrit maqedonas Hristiain Mickoski, VMRO-DPMNE-ja, e cila më 2018 ishte në opozitë, ndërsa tani në pushtet, së bashku me 12 iniciativa të tjera, e kundërshtoi ashpër miratimin e ligjit, nuk mori pjesë në votim dhe e dërgoi këtë dokument menjëherë në Gjykatën Kushtetuese.

Më 11 dhjetor të këtij viti

Gjykata Kushtetuese nuk arriti të marrë një vendim për kushtetutshmërinë e Ligjit për Gjuhët, duke shtyrë kështu seancën për shkak të bojkotit nga dy gjykatësit shqiptarë, Osman Kadriu dhe Naser Ajdari.

Seanca e dytë, më 20 mars

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, Darko Kostadinovski, më 24 dhjetor konfirmoi se seanca e radhës përgatitore e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve do të mbahet më 20 mars të vitit 2025.

Kostadinovski më 23 dhjetor kishte konfirmuar se në listën e emrave për seancë janë përfshirë 20 emra, si ekspertë të së drejtës kushtetuese, të drejtës ndërkombëtare dhe ish-gjykatës nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, të cilët do të ftohen për t'i dhënë mendimet e tyre. Kurse për dy gjykatësit shqiptarë, Osman Kadriu dhe Naser Ajdari, Kostadinovski pret që të jenë të pranishëm dhe t'i paraqesin argumentet e tyre juridike.

Ligji për Përdorimin e Gjuhëve ka pesë vjet që qëndron në sirtarët e Gjykatës Kushtetuese. Balancuesi, mekanizëm që rregullonte përfaqësimin "e drejtë dhe adekuat" të jomaqedonasve në institucionet shtetërore në këtë vend, tashmë i shfuqizuar, dhe Ligji i Gjuhëve u përfshinë në rendin e ditës pak muaj pasi VMRO DPMNE-ja mori pushtetin në Maqedoninë e Veriut.



Hovenieri në paraqitjen e fundit para largimit: Mezi pres të shoh çfarë do të arrini në vitin 2025

Ambasadori amerikan Jeff Hovenier ka bërë paraqitjen e tij të fundit përpara se të largohet nga Kosova. Hovenieri ka thënë se ky dhjetor shënon edhe fundin e shërbimit të tij si ambasador i ShBA-së. Ai e ka falënderuar popullin e Kosovës për miqësinë dhe mikpritjen, duke shtuar se ka qenë nder për të që ka shërbyer në rolin e përfaqësuesit diplomatik amerikan. Ambasadori amerikan ka thënë se mezi pret të shohë se çfarë populli i Kosovës do të arrijë në vitin 2025 dhe më tej.

arrijë në vitin 2025 dhe më tej. “E lë këtë detyrë duke e ditur se e ardhmja e Kosovës është e ndritshme dhe mezi pres të shoh se çfarë ju populli i Kosovës do të arrini në vitin 2025 dhe më tej”, ka thënë Hovenieri.

Hovenieri takon Osmanin: ShBA-ja është e përkushtuar ndaj partneritetit me Kosovën

Ambasadori në largim i Shteteve të Bashkuara në Kosovë, Jeff Hovenier, ka thënë se Uashingtoni dëshiron ta shohë Kosovën të ketë sukses dhe të avancojë, duke shtuar se mbetet i përkushtuar në partneritetin me Prishtinën. Ai këtë deklaratë e bëri pas takimit lamtumirës që zhvilloi me presidenten e Kosovës, Vjosa Osmani, me të cilën vendosën kurora me lule pranë shtatores së ish-presidentit të Kosovës, Ibrahim Rugova. “Dua ta falënderoj popullin e Kosovës. Ka qenë puna ime e ëndrrave që të shërbej ambasador amerikan në

këto tre vjet dhe ta kem mundësinë të punoj me popullin e Kosovës dhe ta ndihmoj shtetin që të përparojë. ShBA-ja është e përkushtuar ndaj partneritetit tonë. Ne duam ta shohim Kosovën që të ketë sukses, të avancojë”, ka thënë Hovenieri.

Hovenieri ka shërbyer ambasador i ShBA-së në Kosovë në tre vjetet e fundit.

Presidentja Osmani e falënderoi Hovenierin për bashkëpunimin në këto tre vjet dhe punën, siç tha ajo, “në mbrojtjen e themeleve të kësaj aleance ekzistenciale për popullin tonë”. Ajo përmendi se Hovenieri është angazhuar për çështjen e Kosovës që një çerek shekulli, pasi tha se ai ishte pjesë e ekipit të presidentit Marti Ahtisaari, i cili hartoi planin që çoi në pavarësinë e Kosovës.

Hovenieri tha se nëse krahasohet Kosova nga vitet '90 me sot, “s'ka dyshim” që shteti ka shënuar përparim. “Po largohem si një mik më i madh i Kosovës sesa kur arrita”, përfundoi ai.

EPOKA E RE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 27 DHJETOR - Ambasadori në largim i ShBA-së në Kosovë, Jeffrey Hovenier, ka thënë se së bashku kanë forcuar partneritetin e qëndrueshëm në mes të popullit të ShBA-së dhe të Kosovës.

Hovenieri përmes një videomesazhi në rrjetin social në “Facebook” ka thënë se ky vit ishte vit i të arriturave të rëndësishme për Kosovën. “Përderisa po e përmbyllem 2024-n, dëshiroj ta shfrytëzoj rastin për të reflektuar për vitin e shkuar. Ishte edhe një vit i të arriturave të rëndësishme për Kosovën. Së bashku kemi forcuar partneritetin e qëndrueshëm mes popullit të

ShBA-së dhe të Kosovës. Disa prej të arriturave përfshijnë: fillimin e Programit Kompakt të Koorporatës së Sfidës së Mijëvjeçarit të ShBA-së, që mundëson investimin e 236 milionë dollarëve në sigurinë dhe sistemet e ruajtjes së energjisë së Kosovës duke ndihmuar në krijimin e të ardhmes më të qëndrueshme për Kosovën. Vizitën e nënsekretares së Shtetit për Diplomaci Publike dhe Marrëdhënie me Publikun, Liz Allen, e cila nënshkroi një marrëveshje dypalëshe me presidenten Osmani për ta rritur bashkëpunimin në luftën kundër ndikimit të huaj dhe manipulimit në medie”, ka thënë ai.

Ai shtoi se do ta kujtojë

gjithmonë kremtimin e 4 korrikut të këtij viti në Ambasadën e ShBA-së. “Të gjithë ne refuzojmë të lejonim shiun e rrëmbyeshëm të pamundësonte të festonim dhe të kërcenim së bashku. Dhjetori shënon përfundimin e shërbimit tim si ambasador i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Republikën e Kosovës. Ju falënderoj të gjithëve, popullin e Kosovës për miqësinë dhe mikpritjen! Jam krenar për atë që kemi arritur së bashku. E lë këtë detyrë duke e ditur se e ardhmja e Kosovës është e ndritshme dhe mundësitë e saj janë të pafundme”, tha ambasadori Hovenier.

Në fund, ambasadori amerikan ka thënë se mezi pret të shohë se çfarë populli i Kosovës do të

300 euro për 50 metra katrorë: Faturat e 'Termokos'-it 'ngrijnë' prishtinasit

Qindra euro kanë qenë faturat për ngrohje për disa qytetarë të Prishtinës gjatë muajit tetor dhe nëntor. Kjo ndodhi pas ndryshimit të mënyrës së faturimit këtë vit nga ndërmarrja publike "Termokos". Disa nga ankuesit dyshojnë se matja e konsumit nuk është bërë siç duhet

PRISHTINË, 27 DHJETOR - Me t'u kthyer nga puna, në një pasdite, në javët e para të dhjetorit, Mehreme Hykolli u përball me një grumbull fqinjësh, të cilët qëndronin të shqetësuar në hyrjen e ndërtesës ku banojnë. "Banorët ishin të shqetësuar, me fatura të 'Termokos'-it në dorë. Shumica ishin mbi 200 euro", tregon Hykolli.

Banorja e lagjes Bregu i Diellit thotë se atë ditë u trondit kur pa faturën e saj të ngrohjes për 30 ditë të nëntorit, në shumën prej 300 eurosh. Hykolli jeton vetëm, në një banesë rreth 50 metrash katrorë. Ajo thotë se vitet e kaluara kishte pranuar fatura prej 35 deri në 37 euro në muaj nga ngrohja e qytetit. "Nuk e duroj nxehtësinë e madhe. Në dhomën e gjumit nuk i ndez radiatorët. I ndez vetëm në sallon, kuzhinë dhe banjë. Unë punoj. Deri në orën 4 nuk jam [në banesë]", thotë Hykolli, e cila nuk e kupton se si iu faturua ky shpenzim.

Këtë vit ndërmarrja "Termokos", e cila është përgjegjëse për ofrimin e ngrohjes për disa lagje të Prishtinës, ka ndryshuar mënyrën e faturimit, e cila kishte qenë në fuqi për shumë vjet.

Më parë, për rreth 25 mijë konsumatorë të "Termokos"-it faturimi përcaktohej bazuar në sipërfaqen e hapësirave të banesave apo shtëpive, me një çmim prej 76 centësh për metër katror.

Me fillimin e sezonit të ngrohjes, më 15 tetor të këtij viti, "Termokos"-i bëri ndryshime rreth faturimit për rreth 7 mijë konsumatorë. Tek ta, paprakisht janë instaluar matës për ta përcaktuar nivelin e shfrytëzimit të ngrohjes, gjë që nuk ishte bërë më parë.

Çmimi për sasinë e shfrytëzimit të ngrohjes për sezonin 2024/2025 u përcaktua nga Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) në Kosovë, me një vendim të datës 12 nëntor 2024. Sipas këtij vendimi, çmimi për ngrohjen me matje është vendosur në 76 centë për kilovat në muaj.

Sezoni i ngrohjes nga "Termokos"-i zakonisht nis më 15 tetor dhe vazhdon deri më 15 prill.

Vendimi për tarifën u mor pasi sezoni i ngrohjes kishte filluar dhe ishin kryer matjet e para për faturat që do të shpërndaheshin në fillim të nëntorit.

ZRRE ka shpjeguar se në këtë



sezon është shtyrë miratimi i tarifave "për shkaqe objektive të ndërlidhura me kërkesën për të dhëna të plota dhe planifikimet për ndërtesat ku janë instaluar alokatorët (HCA) dhe matësit individualë".

Ata kanë shtuar se për faturat e para, pra të gjysmës së tetorit kanë vlejtur tarifën e miratuar në sezonin e kaluar që për konsumatorët me matje ishte 78 centë për kilovat në muaj. Mehreme Hykolli thotë se ka bërë ankesë pranë "Termokos"-it lidhur me faturat e sivjetme, por ende nuk ka marrë përgjigje. "Vendimi im është që çdo muaj t'i mbledh faturat dhe të bëj ankesë për secilin muaj, pastaj t'i dërgoj në gjykatë. Vetëm kështu mund të mbrohem nga përmbaruesi kur të vijë për të m'i marrë gjërat e shtëpisë", thotë ajo.

Për gjysmën e muajit tetor, Hykolli është faturuar 44 euro, shumë e cila për të është e papranueshme, pasi është më e lartë se ajo që e kishte paguar më parë për një muaj të plotë. "Kam marrë trauma nga radiator. Në banjë as nuk guxoj ta ndez më", shton ajo.

Në një deklaratë për "Radion Evropa e Lirë" (REL), "Termokos"-i nuk ka zbuluar numrin e ankesave të konsumatorëve, por ka bërë me dije se "ka formuar një komision për shqyrtimin e

ankesave, i cili po merret me trajtimin e secilës ankesë". "Sistemi i ri i faturimit sipas konsumit është sistem modern dhe i saktë", tha zëdhënësja e "Termokos"-it, Afërdita Uka. "Rreth 70 për qind e konsumatorëve tanë që janë faturuar sipas shpenzimit kanë përfituar fatura më të ulëta, ndërsa vetëm 30 për qind që nuk e kanë shfrytëzuar në mënyrë racionale ngrohjen kanë marrë fatura më të larta", u shpreh ajo.

Me faturën e parë të "Termokos"-it këtë vit u befusua edhe Faton Rama, banor i lagjes "Dardania". Për ngrohjen e banesës prej rreth 90 metrash katrorë, për gjysmën e muajit tetor, ai pranoi faturë prej rreth 80 eurosh.

Duke menduar se mund të kishte ndodhur ndonjë gabim teknik, Rama thotë se vendosi ta priste faturën e radhës për muajin e plotë të nëntorit. "Kur mora faturën e dytë, prej 202 eurosh, ishte e papranueshme", shprehet ai.

Edhe Rama pretendon se ngrohjen e ka shfrytëzuar në mënyrë racionale, sidomos duke pasur parasysh motin jo aq të ftohtë që ka mbajtur deri në këtë kohë. "Unë kam dyshime se matësit nuk po matin si duhet, ose në formë reale. Jam ankuar, nuk kam marrë përgjigje ende", tregon

Rama për "Radion Evropa e Lirë". Ai thotë se po e pret me frikë faturën e muajit dhjetor. Fluksi i ankesave të qytetarëve për faturat e ngrohjes ka nxitur reagimin e iniciativës CorrWatch, një grup i disa organizatave të shoqërisë civile në Kosovë. "Këto fatura janë konsideruar të fryra dhe të shpërputhura me standardet e mbrojtjes së konsumatorëve, duke pasur ndikim të drejtpërdrejtë në besimin e qytetarëve dhe në integritetin e procesit rregullativ në sektorin e ngrohjes termike", është thënë në reagimin e CorrWatch më 23 dhjetor.

Ky grup u ka bërë thirrje "Termokos"-it dhe ZRRE-së, si trup rregullues, që të ndërmarrin masa për shqyrtimin e këtyre faturave, dhe që "kostoja e tepërt të zbritet në faturat e dhjetorit". ZRRE-ja, e cila ka kompetencë për ta bërë auditimin e faturimit, i tha "REL"-it se "në vazhdimësi monitoron, ndër të tjerë, edhe zbatimin e faturimit me matje për ndërtesat e banimit kolektiv", pa dhënë hollësi shtesë mbi gjetjet e monitorimit.

Përveç ankesave zyrtare në "Termokos", qytetarët kanë shprehur pakënaqësinë e tyre për faturat e sivjetme edhe në llogaritë e tyre në rrjetet sociale, përfshirë edhe në ato të vetë

ngrohtores. "Nëse çmimi i ngrohjes me 'Termokos' është ky që e keni faturuar këta dy muaj (trefishi i vitit të kaluar), shumë qytetarë do të detyrohemi të shkëpusim kontratat dhe të vazhdojmë ngrohjen me energji elektrike", shkroi një qytetar në një postim në faqen e "Termokos"-it në "Facebook".

Të tjerë qytetarë, si Hykolli dhe Rama, janë ankuar se kontrolluesi i temperaturës nuk po funksionon siç duhet, pasi radiatorët ngrohin vetëm kur ai vendoset në maksimum, përkatësisht te niveli i pestë. Kështu, ata thonë se janë të detyruar ta shfrytëzojnë nivelin maksimal të nxehtësisë.

Në anën tjetër, sipas udhëzimeve të "Termokos"-it, numri tre është niveli i rekomanduar i vendosjes së kontrolluesit të temperaturës. "Na kanë këshilluar t'i lëshojmë [në nivelin e tretë]. Kur i lëshojmë në tresh, nuk ngrohin fare. Nuk duhet të faturon", thotë Rama.

Sipas "Termokos"-it, në rast se radiatorët nuk ngrohin në nivelin e tretë, "kjo nënkupton se temperatura e brendshme në banesë është më e lartë se 20 gradë celsius".

Derisa presin shqyrtimin e ankesave, qytetarët thonë se nuk kanë mundësi t'i paguajnë faturat e larta. "Vetëm mund ta paramendosh. [Gati] 300 euro për një muaj e gjysmë, shumë gjëra duhet t'i heq nga ushqimi i fëmijëve për t'i paguar ato. Nuk mund ta përballoj atë pagesë", thotë Faton Rama, i cili jeton me bashkëshorten dhe tre fëmijë.

Edhe për Mehreme Hykollin kjo është situatë e papërballueshme. Ajo tregon se një qytetarë që kanë refuzuar ose kanë shmangur vendosjen e matësve, ndërsa vetë ajo kishte pranuar me dëshirë, me idenë se do të kursejë. "Ne që jemi treguar qytetarë bashkëpunues, tani po mërdhijmë", thotë Mehremja.

Për shpërndarjen e ngrohjes, "Termokos"-i shfrytëzon energjinë termike që buron nga termocentrali Kosova B i Korporatës Energjetike të Kosovës, përkatësisht nga avulli i ujit pas djegies së thëngjillit. Ky sistem ka hyrë në fuqi nga viti 2014.

Deri në vitin 2014 "Termokos"-i ka përdorur mazutin si lëndë djegëse, por furnizimi me ngrohje nuk ka qenë gjithmonë i kënaqshëm.

Hamza: Zvicra i ka dhënë gjithnjë përkrahje Kosovës

PRISHTINË, 27 DHJETOR - Kandidati për kryeministër i PDK-së, Bedri Hamza, aktualisht kryetar i komunës së Mitrovicës, ka takuar përfaqësuesin e

Zvicrës në Kosovë, ambasadorin Jurg Sprecher, me të cilin ka biseduar për zhvillimet në Kosovë dhe marrëdhëniet e shkëlqyera mes dy vendeve

tona. “Në çdo fushë të jetës sociale dhe ekonomike, si në të kaluarën, ashtu edhe sot, Zvicra i ka dhënë gjithnjë përkrahje Kosovës.

Kosova është e përkushtuar të ndërtojë paqe të qëndrueshme dhe të ecë përpara në rrugën e integreimeve euroatlantike”, ka thënë Hamza.



Mbyllet edhe një institucion paralel në veri të Kosovës

MITROVICË, 27 DHJETOR - Policia e Kosovës ka mbyllur më 27 dhjetor një tjetër institucion që vepron sipas sistemit të Serbisë - Ndërmarrja Publike për Urbanizëm në Mitrovicën e Veriut, ka konfirmuar për “Radio Evropën e Lirë” zëvendës drejtori i policisë për rajonin e veriut, Veton Elshani. Ai tregoi se policia ka reaguar pasi ka pranuar informacion se një ndërtesë banimi afër Shkollës Teknike në Mitrovicë të Veriut dhe më pas ky informacion u vërtetua si i saktë. “Pasi që është kontaktuar prokurori i rastit, dokumentet që u gjetën atje u konfiskuan dhe disa persona u intervistuan dhe rasti si falsifikim i dokumenteve i bashkëngjitet rastit të mëhershëm që e kishim me strukturën paralele të Mitrovicës së Veriut”, tha Elshani, duke shtuar se nuk ka të arrestuar për këtë rast. Kryeministri i Serbisë, Millosh Vuçević, e dënoi mbylljen e Ndërmarrjes Publike për Urbanizëm në Mitrovicën e Veriut, duke e akuzuar kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, se po përpiqet ta “destabilizojë rajonin me lëvizje të njëanshme” në Kosovë. “Edhe



një herë po i shohim pamjet e turpshme të pafuqisë së Kurtit. Ai vazhdon t’i terrorizojë serbët dhe pushimet i shfrytëzon për të vazhduar me skenarin e tij terrorist dhe plaçkitjen e jashtëligjshme të pronave serbe në veri të Kosovës dhe ‘Metohisë’”, shkroi ai në “Instagram”. Sipas tij, në këtë ndërmarrje ishin të punësuar dhjetë punëtorë. Një ditë më herët u mbyllën dy

ndërmarrje publike serbe, që punonin sipas sistemit të Serbisë: Drejtorja për Hapësirën Banesore dhe Biznesore dhe Drejtorja për Tokën Ndërtimore. Sipas ministrit të Punëve të Brendshme të Kosovës, Xhelal Sveçla, këto institucione të mbyllura kundërligjshëm kanë grumbulluar pagesa nga qytetarët dhe bizneset për shfrytëzimin “e objekteve që janë, kinse, nën menaxhimin e tyre”.

Ndërkaq, Lista Serbe, partia kryesore e serbëve në Kosovë që ka mbështetjen e Beogradit, ka thënë se Qeveria e kryeministrit Albin Kurti po vazhdon me “aksione të paligjshme, përshkallëzuese” në veri të Kosovës. Nga kjo parti thanë se do të bisedojnë me punonjësit e institucioneve të mbyllura për t’i shqyrtuar mundësitë e mbështetjes dhe ndihmës që mund t’u ofrohet atyre.

Institucionet në Kosovë që vepron në sistemin e Serbisë konsiderohen të paligjshme dhe, për këtë arsye, që në fillim të vitit ka nisur mbyllja e tyre. Deri tani janë mbyllur disa organe të përkohshme komunale, Posta e Serbisë në veri të Kosovës, Banka Kursimore e Postës, Instituti për Sigurime Pensionale dhe Invalidore në Mitrovicën e Veriut, kasaforta e Bankës Popullore të Serbisë në Leposaviç, si dhe disa kompani komunale.

Po ashtu, Kosova ka ndaluar përdorimin e dinarit serb, gjë që ka vështirësuar pagesën e pagave për pjesëtarët e komunitetit serb që marrin rroga nga buxheti i Serbisë.

Këto hapa Qeveria e Kosovës ka thënë se i ka ndërmarrë për ta shtrirë sovranitetin, por është kritikuar nga komuniteti ndërkombëtar që kërkon që këto çështje të zgjidhen në kuadër të dialogut të Brukselit, në mënyrë që të shmangët rritja e tensioneve në terren.

Në anën tjetër, Serbia refuzon t’i mbyllë institucionet e saj në territorin e Kosovës dhe shumicën e tyre i ka zhvendosur afër pikave kufitare nga ana e Serbisë.

Vendoset gurthemeli i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Drenas

DRENAS, 27 DHJETOR - Kryeministri Albin Kurti dhe ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, së bashku me kryetarin e komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, vendosën gurthemelin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare. Me një vlerë afër tre milionë euro, ky projekt i nënshkruar më 15 nëntor të këtij viti po realizohet si rezultat i Marrëveshjes së Mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe komunës së Drenasit, e i cili pritet të finalizohet dhe të funksionalizohet në shtator të vitit



2025. Kurti ka thënë se Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare, me sipërfaqe prej 4 235 metrash katrorë, do të ketë kushte të dinjitetshme për stafin mjekësor dhe kushte të mira për shërimin e

të gjithë pacientëve. “Qendra do të ofrojë shërbime në repartin e radiologjisë, emergjencës, të gjinekologjisë, mjekësisë familjare, si dhe shërbime teknike. Ajo do të ketë podrumin, përdheshen dhe katin e parë, si dhe do të ketë vend për administratën”, ka thënë Kurti. Kryeministri Kurti uroi qytetarët e Drenasit për fillimin e këtij projekti, teksa theksoi se synimi kryesor i tij dhe i Qeverisë së Republikës së Kosovës është që shërbimi dhe kujdesi mjekësor të jenë edhe sa më cilësorë edhe sa më afër qytetarëve.

Rahoveci bëhet me shërbim të hemodializës

RAHOVEC, 27 DHJETOR - Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, ka bërë me dije se kanë përfunduar Shërbimin e Hemodializës në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Rahovec. Ai ka thënë se ky projekt tani po jetësohet si një shërbim i domosdoshëm për pacientët e Rahovecit. “Tani e tutje ky shërbim jetik është shumë më afër, duke shmangur udhëtimet e lodhshme, disaorëshe dhe disa herë në javë



drejt qyteteve të tjera për trajtim. Falënderojmë ShSKUK-në dhe komunën e Rahovecit për kontributin. Stafit shëndetësor i urojmë punë të mbarë, ndërsa pacientëve trajtim të suksesshëm”, ka thënë Vitia.

Burgim i përjetshëm për të akuzuarin për vrasjen e bashkëshortes në Pejë

PEJË, 27 DHJETOR - Gjykata Themelore në Pejë ka dënuar me burgim të përjetshëm Edmond Lajqin, të akuzuar për vrasjen e bashkëshortes

së tij, Gj. U. Në shqiptimin e dënimit, gjykatësi Musë Povataj tha se Lajqi ka kryer veprën “vrasje e rëndë”, ndërkaq për armëmbajtje pa leje, i

akuzuari nuk është dënuar derisa të konfiskohet arma me të cilën është kryer krimi. Vendimi është mirëpritur nga familja e së ndjerës.

Vëllai i saj Shpat Ukella tha se ky dënim ua lehtësoi “sadopak dhimbjen”. Më 16 prill të këtij viti Lajqi kishte vrarë bashkëshorten me armë

zjarri në banesën e tyre në Pejë. Pas aktit, ai ishte vetëdorëzuar në polici. Lajqi e pranoi fajësinë gjatë seancës gjyqësore më 24 dhjetor.

Aktakuzë kundër pesë të dyshuarve për krime lufte në Kosovë

PRISHTINË, 27 DHJETOR - Prokuroria Speciale e Kosovës ka njoftuar të premten se ka ngritur aktakuzë kundër pesë të dyshuarve për krime lufte kundër popullsisë civile gjatë luftës në Kosovë më 1998-1999. Pesë të dyshuarit, me inicialet D. C., D. N., M. Sh., N. S. dhe S. J., akuzohen se në bashkëkryerje dhe si pjesë e një grupi kriminal kanë marrë pjesë në vrasjen e tetë civilëve shqiptarë në rajonin e Gjilanit gjatë luftës, thuhet në njoftim. "Dy nga këto viktime i kanë vendosur në grumbull drurësh, ku një nga ta është djegur për së gjalli", tha Prokuroria. Ata dyshohen se, edhe me

pjesëtarë të tjerë të paidentifikuar të këtij grupi, të armatosur dhe të veshur me uniforma të kamufluara dhe uniforma jo të rregullta të policisë apo ushtrisë serbe, i kishin rrahur, maltretuar, torturuar, plaçkitur dhe dëbuar civilët shqiptarë gjatë luftës, sipas aktakuzës. Të pandehurit M. Sh. dhe N. S. akuzohen edhe për armëmbajtje pa leje, thuhet në aktakuzë. Dhjetorin e kaluar Prokuroria Speciale e Kosovës kishte thënë se ka ngritur gjithsej 33 aktakuza, që përfshijnë 89 persona, për krime lufte në Kosovë.



Prej përfundimit të luftës së fundit në Kosovë rreth 70 persona janë dënuar për krime lufte para institucioneve

vendore dhe ndërkombëtare. Nga viti 2000 deri në vitin 2008, krimet e luftës në Kosovë janë hetuar nga Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), ndërsa nga viti 2008 prej Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit (EULEX). Në vitin 2018 ky mision i ka dorëzuar lëndët në Prokurorinë e Kosovës dhe në gjykatat vendore. Gjatë luftës së fundit në Kosovë më 1998-1999 janë vrarë mbi 13 000 civilë dhe mijëra të tjerë janë zhdukur. Mbi 1 600 persona vazhdojnë të jenë ende të pagjetur - pjesa më e madhe e tyre shqiptarë.

Konfirmohet rasti i parë me linë e majmunëve në Kosovë

PRISHTINË, 27 DHJETOR - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës tha se është konfirmuar rasti i parë në Kosovë me Mpox, apo linë e majmunëve. I infektuari me këtë virus është një shtetas i Kosovës i moshës 30-vjeçare. IKShPK tha se ai ishte hospitalizuar në Klinikën Infektive të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës më 24 dhjetor, pasi ishte kthyer nga Afrika Perëndimore dhe kishte këto simptoma: temperaturë, ethe, ndryshime në lëkurë, në fytyrë, në duar dhe kruarje. "Pacienti është në gjendje



stabile shëndetësore. IKShPK i ka gjurmuar të gjitha kontaktet e deklaruar të personit të infektuar dhe të familjarëve të tij, të cilëve u janë dhënë rekomandimet për masat e parandalimit dhe të kontrollit të infeksionit", u tha në njoftim. Instituti bëri thirrje për kujdes, teksa shtoi se personat që preken nga linë e majmunëve zakonisht përjetojnë simptoma të lehta apo mesatare, të cilat, sipas IKShPK-së, zgjasin dy deri në katër javë. Linë e majmunëve përhapet përmes kontaktit të ngushtë.

Zakonisht përcillet me simptoma të buta, por në disa raste virusi mund të jetë fatal për njeriun. Virusit përcillet me simptoma sikurse ato të gripit, si dhe me puçra të mbushura me qelb nëpër trup. Në gusht, Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) e shpalli atë si emergjencë globale për shëndetin publik. Shpallja e një sëmundjeje si emergjencë globale për shëndetin publik, nënkupton që mund të ndahen më shumë fonde dhe të merren masa në nivel global për ta parandaluar përhapjen virusit.

Projekti i BE-së, avancim i digjitalizimit dhe trajnim për personelin e UP-së

PRISHTINË, 27 DHJETOR - Rektori Arben Hajrullahu është takuar me Arianit Kurtin, partner i projektit të BE-së "Tkaedite" dhe koordinatoren e UP-së në këtë projekt, Krenare Pireva-Nuçin. Projekti "Tkaedite", i fokusuar në digjitalizimin dhe inovacionin në arsim, që nënkupton përdorimin e teknologjive digjitale dhe inteligjencës artificiale nga studentët, profesorët e administrata, është duke ndihmuar në këto fusha, programin bachelor për teknologjinë arsimore në Fakultetin e Edukimit. Pas takimit profesori i

Universitetit të Linnaeusit të Suedisë, Arianit Kurti, i mbajti trajnim personelit akademik të Universitetit të Prishtinës në lidhje me dizajnimin e projekt-propozimeve për thirrjet e projektit Erasmus+. Rektori Hajrullahu falënderoi profesorin Kurti për trajnimin, duke shprehur optimizmin që bashkëpunimi ndëruniversitar do të sjellë projekte të reja dhe inovative për zhvillimin e mëtejshëm të Universitetit të Prishtinës. "Shpresoj që në takimin e ardhshëm të kemi rastin të përurojmë projekte të reja të suksesshme, të fituara falë



kësaj përvoje të ndarë nga partnerët tanë", tha rektori

Hajrullahu. Edhe Mimika Dobrosi, nga Zyra

e Erasmus+ në Kosovë, vlerësoi lart trajnimin për projektin e Bashkimit Evropian që mbështet arsimin, rininë e sportin. Në fund të tetorit 2024 rektori Arben Hajrullahu ishte takuar me përfaqësuesit e Zyrës së Erasmus+ në Kosovë dhe atëherë ishte diskutuar për avancimin e Universitetit të Prishtinës në një projekt të tillë. Kosova është pjesë e programit Erasmus+ që nga viti 2015, ndërsa prej tij deri tash kanë përfituar 6278 studentë e profesorë të institucioneve të arsimit të lartë, duke studiuar në Evropë.

Osmani dekreton 24 prokurorë të rinj

Prishtinë, 27 dhjetor - Presidentja Vjosa Osmani, me propozim të Këshillit Prokurorial të Kosovës, ka dekretuar 24 prokurorë, pothuajse gjysma prej tyre gra. Në ceremoninë e betimit para Presidentes së Republikës, prokurorët e rinj janë betuar

se "do t'i qëndrojnë besnik Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ligjeve në fuqi dhe do t'i respektojnë rregullat e etikës profesionale". Presidentja Osmani, ndër të tjera, ka theksuar rëndësinë e integritetit, pavarësisë, paanshmërisë dhe

profesionalizmit të prokurorëve, si elemente thelbësore për një sistem që garanton drejtësi për të gjithë qytetarët e Kosovës, njëkohësisht u ka bërë thirrje prokurorëve të rinj që të mos kenë kompromis ndaj kimit dhe korrupsionit.



Autoritetet energjetike: S'ka mungesë të rrymës, por mbingarkesë të rrjetit

PRISHTINË, 27 DHJETOR - Ndërprerjet me furnizim me energji elektrike po ndodhin për shkak të mbingarkesës së rrjetit për shkak të rritjes së konsumit, e jo për shkak të mungesës së energjisë, tha shefi ekzekutiv i Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT), Evetar Zeqiri. Këtë deklaratë ai e bëri pas takimit që ministria e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, zhvilloi me KOSTT-in dhe Kompaninë Kosovare për Shpërndarjen e Energjisë (KEDS). "Nuk ka mungesë të rrymës. Ne jemi duke prodhuar në maksimum në katër blloqe. KESCO po importon energjinë e munguar. Nuk bëhet fjalë për mungesë të energjisë, por për ngarkesë që ka prekur kufijtë", tha Zeqiri. "Problemi është i përkohshëm, vetëm në këtë javë dhe javën tjetër dhe pas kësaj pritet të çlirohen kapacitetet, të ulet ngarkesa dhe nuk do të ketë pengesa", shtoi ai.

Ditët e fundit qytetarë në pjesë të ndryshme të Kosovës janë ankuar për shkak të ndërprerjeve të energjisë elektrike. Institucionet e Kosovës, ndërkaq, u kanë bërë thirrje atyre ta kursejnë energjinë për shkak të mbingarkesës së rrjetit.

Ndërkaq, drejtori i Operimit të Sistemit në KEDS, Bujar Jupaj, tha për mediet se në periudhën nëntor - dhjetor ka pasur rritje të ngarkesës për 30 për qind, duke argumentuar se "ka rritje të kërkesës së paparashikuar".

Ai tha se KEDS-i do të angazhojë 1 000 punëtorë shtesë për të intervenuar në rastet e mbingarkesës së rrjetit. "KEDS-i ka rreth 730 mijë

konsumatorë dhe nga të dhënat që i kemi, mbi 95 për qind të konsumatorëve që furnizohen në të njëjtën kohë. Po flasim për një pesëpërqindësh të cilët e kanë një problem si pasojë e mbingarkesës", tha ai, duke shtuar se piku i ngarkesës së rrjetit është arritur javën e kaluar me 2 500 megavate të shpenzuara.

"Radio Evropa e Lirë" ka raportuar se bizneseve po u shkakton telashe mungesa e energjisë elektrike, ndërkaq përfaqësuesit e shoqërisë civile kanë thënë se institucionet ishin të papërgatitura për stinën e dimrit dhe masat e ndërmarra në vitet e fundit, sikurse subvencionimi i pajisjeve eficientë për ngrohje kanë çuar në rritje të konsumit. "Subvencionimi i pajisjeve elektrike eficientë ka rezultuar që shumë konsumatorë t'i ndryshojnë mënyrat e ngrohjes, duke kaluar në ngrohje me energji elektrike, qoftë përmes investimeve në klima apo pompa termike. Kjo ka shtuar kërkesën për energji në sistem, sepse qytetarët kanë kaluar nga ngrohjet me lëndë djegëse tradicionale, në ngrohje me rrymë", tha Dardan Abazi nga Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP).

Por, kështu nuk mendon ministria Rizvanolli. Ajo e cilësoi "të pasaktë" lidhjen e çështjes së subvencionimit të pajisjeve me rritjen e ngarkesës së rrjetit. "Sigurisht që kur janë dizajnuar skemat e subvencionimit është menduar çdo detaj. Prandaj, edhe ka qenë kushti që nuk mund të përfitoni nga pajisjet ngrohëse eficientë që ngrohni me energji



elektrike, përveç nëse jeni konsumator që ngrohni me energji elektrike me pajisje joeficientë dhe nuk keni asnjë opsion tjetër", tha Rizvanolli. Sipas saj, nga të dhënat e viteve paraprake, përfituesit e subvencioneve për pajisje eficientë për ngrohje me rrymë kanë konsumuar më pak energji elektrike. Megjithatë, ajo shtoi se në rrjet në tre vjetet e fundit është rritur numri i konsumatorëve

përkatesisht, sipas saj, janë 60 000 amvisëri të reja të kyçura në rrjet dhe 8 500 biznese. Ministria e Ekonomisë e Qeverisë së Kosovës që nga viti 2022 disa herë ka ndarë subvencione për qytetarët që blejnë pajisje eficientë për ngrohje, përfshirë pompa termike, kondicionerë/klima efikase, si dhe kaldaja me biomasë (dru, pelet, briket) dhe stufa individuale me biomasë. Thirrja e fundit u bë edhe në

shtator të këtij viti.

Në janar të këtij viti ajo ka njoftuar se gjatë dy viteve të fundit janë realizuar pagesa për mbi 15 mijë familje, në vlerë rreth shtatë milionë euro.

Kosova aktualisht prodhon energji elektrike në dy termocentralet, Kosova A dhe B, që funksionojnë me thëngjill. Por, shteti, po ashtu, importon rrymë me qëllim që t'i përmbushë kërkesat në rritje të konsumatorëve.

BQK-ja lansoi Platformën për Krahasimin e Produkteve dhe Shërbimeve Financiare



Prishtinë, 27 dhjetor - Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) në kuadër të angazhimit të saj për Edukimin Financiar ka lansuar në fazë testuese Platformën për Krahasimin e Produkteve dhe Shërbimeve Financiare. Faza e testimit do të zgjasë për një kohë të caktuar derisa merren komente dhe finalizohet legjislacioni përkatës. Platforma ka për qëllim të ofrojë transparencë më të madhe në tregun financiar, duke ndihmuar qytetarët të marrin informacione mbi

normat e interesit dhe tarifën për produktet dhe shërbimet më të përdorura financiare të ofruara nga institucionet financiare për individ. Platforma u mundëson qytetarëve t'i krahasojnë ofertat e ndryshme të sektorit bankar për produktet e njëjta për ta bërë zgjedhjen më të përshtatshme sipas nevojave të tyre. Qëllimi i Platformës është ta mbështesë edukimin financiar, ta rrisë transparencën dhe mbrojtjen e konsumatorëve, si dhe të avancojë qasjen në

financa për qytetarët në vend. "Në këtë fazë në platformë janë shpallur produktet dhe shërbimet më të përdorura financiare për individ në sektorin bankar, megjithatë planifikohet që të zhvillohet dhe plotësohet me informata shtesë për sektorin bankar, si pjesa e pagesave - transferëve bankare, pastaj me produkte për institucionet mikrofinanciare, institucionet financiare jobankare dhe produkte të kompanive të sigurimeve", thuhet në njoftimin e BQK-së.

Limaj: Shumat marramendëse të paguara për import të energjisë, fytyra e vërtetë e kësaj qeverie

PRISHTINË, 27 DHJETOR - Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka thënë se statistikën e publikuar në medie për shumatat marramendëse të paguara për import të energjisë elektrike tregojnë fytyrën e

vërtetë të kësaj qeverie. "Për katër vite, sipas raporteve të publikuara janë shpenzuar rreth 560 milionë euro për të blerë rrymë. Kjo më të vërtetë është skandaloze. Prandaj, të nderuar qytetarë, është shumë më


rëndësi ta kemi pavarësimin energjetik. Dhe ne do ta bëjmë, nëse na jepni besimin më 9 shkurt. Brenda tri viteve, ne do ta ndërtojmë termocentralin më 500 megavat dhe do ta zgjidhim një herë e përgjithmonë

çështjen e energjisë elektrike. Prioriteti ynë është edhe renovimi dhe transformimi i blloqeve ekzistuese. Ky është zotimi im dhe më mbani për fjalë", ka shkruar Limaj në "Facebook".



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Në fundjavë zhvillohet xhiroja e fundit për vitin 2024

PRISHTINË, 27 DHJETOR - Në fundjavë zhvillohet xhiroja e 14-t e ProCredit Superligës në basketboll apo e fundit për vitin 2024. Sfida hapëse është ndërmjet Bashkimit dhe Pejës, dy skuadra me traditë në basketbollin e Kosovës. Prizrenasit janë në vendin e dytë me nëntë fitore e katër humbje, ndërsa pejanët në vendin e tretë me shtatë fitore e gjashtë humbje, andaj pritet përballje mjaft interesante në Prizren. Takimi i dytë i së shtunës është në mes të Trepçës dhe Borës që zhvillohet në palestrën "1 Tetori". Kampionët janë në vendin e parë me dhjetë fitore e tri humbje, kurse prishtinasit



kanë pasur ngritje të formës, ku tashmë janë në vendin e shtatë me katër fitore e dhjetë humbje. Sfidë shumë interesante pritet ndërmjet Vëllaznimit dhe Sigal Prishtinës, të dielën në Gjakovë. Të dy skuadrat kanë nga gjashtë fitore e shtatë

humbje, duke bërë që të presim një përballje mjaft interesante. Ndeshja e fundit e kësaj xhiroje dhe e fundit për këtë vit është ndërmjet Proton Cable Prizrenit dhe Golden Eagle Yllit. Prizrenasit kanë tri fitore e 11 humbje, ndërsa therandasit shtatë fitore e gjashtë humbje.

PROCREDIT SUPERLIGA - JAVA 14

Të shtunën takohen:
17:00 Bashkimi - Peja
19:00 Trepça - Bora

Të dielën takohen:
17:00 Vëllaznimi - Sigal Prishtina
19:00 Proton Cabel Prizreni - Golden Eagle Ylli

Kryetari i Kamenicës pret në takim futbollistin Donat Rrudhani

KAMENICË, 27 DHJETOR - Kryetari i komunës së Kamenicës, Kadri Rahimaj, së bashku me drejtorin për Kulturë, Rini dhe Sport e kanë pritur të premtën në takim futbollistin e Përfaqësueses së Kosovës, Donat Rrudhani. "Donati na bën krenarë si komunë e si vend. Pata kënaqësinë që sot në zyrë të pres talentin kamenicas, futbollistin e dëshmuar të Përfaqësueses së Kosovës, Donat Rrudhani. Folëm për sukseset e tij të shumta, përfaqësimin dinjitoz që i bën vendit në ekipin e përfaqësueses, por edhe neve si qytet. I tregova nga afër edhe punët e mira si dhe investimet që po bëhen në infrastrukturën sportive. Kamenica ka një numër talentësh të dëshmuar



në futboll, e për ne është detyrë të krijojmë kushte sa më të mira, ambient të përshtatshëm e mbështetje të vazhdueshme

për ata që do të vijnë në vazhdim. Faleminderit për vizitën, Donat!", ka shkruar Rrahimaj në "Facebook".

SHKURT

FHK-ja mban Kuvendin Zgjedhor më 30 janar

Bordi i Federatës së Hendbollit të Kosovës e ka mbajtur mbledhjen e fundit për këtë vit. Udhëhequr nga presidenti Eugen Saraçini, Bordi e kishte mbledhjen e radhës të enjten dhe mori vendime të rëndësishme. U vendos që Kuvendi i Punës dhe Kuvendi Zgjedhor i Federatës së Hendbollit të Kosovës të mbahen më 30 janar. Po ashtu, është vendosur që prej 8 deri më 15 janar të jetë i hapur afati kalimtar dimëror. Bordi ka analizuar edhe aktivitetet gjatë vitit 2024, duke vlerësuar të arriturat dhe zhvillimin e vazhdueshëm.

Egnatia rrëmben Superkupën e Shqipërisë

Egnatia është Superkampionë e Shqipërisë. Rrogozhinasit triumfuan 2-0 në "Arenën Kombëtare" përballë Kukësit, duke fituar kështu trofeun e parë të sezonit, një trofe që nuk vlen asnjë qindarkë fitim për klubin. Egnatia si kampionë dhe fituese e Kupës u përball me Kukësin si finalist i Kupës sezonin e kaluar, me verilindorët që nuk arritën dot t'i rezistonin "furisë" së rrogozhinasve. Këta ta fundit e nisën mjaft mirë takimin, duke kaluar në avantazh me Ujkën në minutën e 19 të takimit. Pjesa e dytë gjithashtu foli për kampionët e Shqipërisë, të cilët shënuan të dytin në minutën e 84 me Bakayokon, duke "hipotekuar" trofeun dhe duke kompletuar "Tripletën" (Kampionat, Kupë, Superkupë).

Empoli pret ofertat për Ismajlin

Drejtuësit e skuadrës së Empolit tashmë kanë marrë vendimin përfundimtar për mbrojtësin Ardan Ismajli. Tek Empoli kanë vendosur ta nxjerrin në shitje Ismajlin në afatin kalimtar të janarit dhe janë në pritje të ofertave për kartonin e tij, pasi 28-vjeçari ka refuzuar rinovimin e kontratës që i skadon në fund të sezonit. Interesim të fortë për Ismajlin kanë shprehur Juventus dhe Napoli, me këta të fundit që po vlerësohen favoritë për transferimin e tij. Megjithatë, për t'i siguruar shërbimet e Ismajlit, skuadrat e interesuara duhet të paktën të ofrojnë 3 milionë euro pasi kjo është shuma e caktuar nga Empoli. Ismajli po shkëlqen këtë sezon në Serinë A dhe më herët është raportuar se ka arritur marrëveshje me Napolin, por tek Empoli insistojnë se ende nuk kanë ofertë zyrtare për kapitenin dhe se janë në pritje të ofertave. Këtë sezon Ismajli ka 17 ndeshje në Serinë A, kampionat në të cilin luan që prej vitit 2020, pasi para Empolit ka bërë karrierë edhe te Spezia.

Barça humbet gjyqin, Olmo mund të largohet

Barcelona ndodhet në një situatë kaotike në lidhje me regjistrimin e lojtarëve. Gjykata ka vendosur kundër katalanasve për padinë e bërë ndaj La Ligas në lidhje me çështjen e Dani Olmo. Ky i fundit u afrua në merkaton e verës për 60 milionë euro nga Leipzig, ndërsa nga 1 janari do të jetë lojtar i lirë dhe mund ta zgjedhë vetë skuadrën e re. Te Barcelona kanë vendosur ta apelojnë vendimin, duke kërkuar të lejohet regjistrimi i fantazistit spanjoll. Gjykata vendosi në favor të La Ligës, me shpjegimin se Barcelona nuk respekton rregullat e "Fair-Play Financiar" në Spanjë. Në Gjykatën e Shkallës së Parë Barcelona ka ngritur një tjetër padi, me vendimin që do të merret më 30 dhjetor. Në rast se edhe këtë herë vendoset kundër klubit, Olmo mund të largohet falas në merkaton e dimrit.

Milwaukee zhgënjën sërish, Oklahoma lidere në Perëndim

Milwaukee, 27 dhjetor - Ekipi i Milwaukeees zhgënjëu sërish, duke u mundur me rezultat 111-105 në fushën e vet nga Brooklyn. Johnsoni me 29 pikë ishte vendimtar për miqtë, ndërkohë që për Bucksin u ndje mungesa e Antetokounmpos. Oklahoma vijon të jetë lidere në Perëndim, duke fituar me rezultat 120-114 në fushën e

Indianas. Alexander Shai me 45 pikë mbetet lider për Thunderin. Jashtë fushës fitoi edhe Houstoni, që mundi me rezultat 128-111 New Orleansin. Jalen Green me 30 pikë ishte më i miri në fushë. Ndeshje spektakolare për Memphisin, që fitoi me rezultat 155-126 ndaj Torontos, duke vendosur rekordin sezonal të pikëve të realizuara nga një

ekip në një takim. Tetë lojtarë të Memphisit realizuan mbi 11 pikë. Fitore të madhe korri edhe Atlanta, që mundi me rezultat 141-133 Chicagon, sfidë ku Jalen Johnsoni realizoi 30 pikë e 15 rebounde. Ndërsa Miami fitoi me rezultat 89-88 në sekondat e fundit ndaj Orlandos, ndeshje ku u dallua Tyler Herro me 20 pikë.



REZULTAT

Indiana - Oklahoma	114-120
Orlando - Miami	88-89
Washington - Charlotte	113-110
Atlanta - Chicago	141-133
Memphis - Toronto	155-126
Milwaukee - Brooklyn	105-111
New Orleans - Houston	111-128
Portland - Utah Jazz	122-120
Sacramento - Detroit	113-114

MotoGP rikthehet në Brazil pas 20 vjetësh

GOIANIA, 27 DHJETOR - Botërori i MotoGP rikthehet në Brazil pas 20 vjetësh. Pista ndërkombëtare në zonën e Goiania, "Ayrton Senna", do t'i mirëpresë garat e MotoGP për 5 sezone me radhë, nga viti 2026 deri në vitin 2031. Në

këtë pistë janë zhvilluar edhe më parë garat e MotoGP nga viti 1987 deri në 1989. Më pas në Brazil janë zhvilluar gara në pista të tjera. Gjithsesi, rikthimi në Brazil pas dy dekadash është një lajm i madh për motoçiklizmin.

Rikthimi në Brazil vjen pas një marrëveshje që ka arritur MotoGP, qeverisë së Goias dhe Brasil Motorsport. "Rikthimi i MotoGP në Goias është një moment historik për ne. Goiania do të jetë, gjatë pesë viteve të ardhshme,

shtëpia e MotoGP në Brazil", thanë drejtuesit e garës. "Ne po punojmë për të siguruar që infrastruktura dhe shërbimet të ofrojnë një përvojë të paharrueshme për pilotët, ekipet dhe të apasionuarit pas këtij sporti",



ka thënë guvernatori Ronaldo Caiado.

Egzon Gjuka e Salemateu Camara, më të mirët e vitit 2024



PRISHTINË, 27 DHJETOR - Federata e Hendbollit e Kosovës të enjten mbrëma i ka shpallur më të mirët e vitit 2024. Ceremonia "Laureatët 2024" është mbajtur në "Hotel International Prishtina". Në ceremoni ishte edhe kryeministri i Kosovës, Albin Kurti. Pos tij, edhe ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku, zëvendësministria për Kulturë, Rini dhe Sport, Daulina Osmani, presidenti i Komitetit Olimpik të Kosovës, Ismet Krasniqi dhe shumë doajenë të hendbollit, drejtues klubesh, punëtorë të hendbollit, hendbollistë e hendbolliste. Ceremoninë e hapi presidenti Eugen Saraçini, që paraqiti të arriturat e federatës sonë gjatë vitit që po e lëmë pas. Për herë të katërt rresht hendbollisti më i mirë në Kosovë është shpallur Egzon Gjuka. Ai e udhëhoqi Rahovecin drejt titullit të kampionit, ndërsa u shqua edhe te Kombëtarja e Kosovës. Hendbollistja e Ferizajt, Salemateu Camara, u shpall më e mira e vitit. Hendbollistja nga Guinea ka shkëlqyer gjatë gjithë vitit, ndërsa me Ferizajn ka fituar Kupën dhe Superkupën e Kosovës. Lojtarët më të mirë të Kombëtares u shpallën Bujar Ramosaj e

Arlinda Hajdari. Në shtatëshen më të mirë te hendbollistët kanë zënë vend Arbër Curri, Lulzim Shabani, Jon Muqolli, Egzon Gjuka, Jeton Bislimi, Arbios Mushkolaj e Enis Kuleta. Rron Ramadani është shpallur lojtari më i mirë i mbrojtjes, ndërsa Albi Gjuka është golashënuesi më i mirë i vitit me 229 gola. Te hendbollistët në shtatëshen më të mirë kanë zënë vend Blerta Ahmetxhekaj, Luljeta Sopjani, Orgesa Gola, Salemateu Camara, Fetane Uzunlar, Sevdanur Ozkan e Arlinda Dinarica. Shkurta Mehmeti është shpallur lojtaria më e mirë e mbrojtjes, ndërsa Alma Nivokazi është golashënuesja më e mirë e vitit me 147 gola. Rahoveci te meshkujt dhe Istogu te femrat janë shpallur klubet më të mira të vitit. Te juniorët klubi më i mirë është shpallur Besa Famgas. Te kadetët klubet më të mira ishin Besa Famgas e KHF Shqiponja. KH Trepça e KHF Shqiponja janë klubet më të mira te pionierët, ndërsa KH Istogu e KHF Prishtina te njomakët. Verim Zherka e Faruk Shala janë shpallur trajnerët më të mirë të vitit, ndërsa Besfort Jahja e Sherif Xhema janë gjyqtarët më të mirë të vitit 2024 në hendbollin kosovar. Demë Sadiku është shpallur

Punëtori Sportiv i vitit 2024. Shpresa të vitit te vajzat janë shpallur Elisa Gjickolli, Rejhane Murati, Rinesa Jashari, Natyrë Arifi, Ardiola Surdullli, Rita Hasanaj e Valza Manxhuka. Te djemtë shpresa të vitit janë: Ajan Muqolli, Orges Mavraj, Jon Miftari, Aldon Sahiti, Enes Hasani, Ali Bajqinovci e Adis Vula. Janë nderuar edhe partnerët e Federatës: MKRS, KOK, KEP Trust, NLB Banka, Ujë Rugove, MiniMax, Hotel Emery e Hotel International Prishtina. FHK-ja ka çmuar edhe bashkëpunimin shembullor me gazetarë, ndërsa ceremonia nisi duke nderuar personalitetet që kanë ndërruar jetë gjatë vitit 2024. Me mirënjohje post-mortem janë nderuar ish-sekretari i përgjithshëm i FHK-së, Izet Gjinovci, që gjithë jetën ia kushtoi sportit të hendbollit e mbi dy dekada dha kontribut të çmuar për FHK-në. Pastaj ish-komisarja e garave, Shqipe Bajçinca-Brestovci, Muhamet Alaj, Aziz Makiqi, Nebahate Brahaj Gashi, Skender Alija, Murat Kastrati, Argjend Dreshaj, Qerkin Morina, Kadrije Sllamniku Basha e Rexhep Haxhimusa. Me shpalljen e më të mirëve kanë përfunduar aktivitetet e FHK-së për vitin 2024.

SHKURT

Trabzonspor i dëshiron Manajn në janar

Sulmuesi i Kombëtares së Shqipërisë, Rey Manaj, nuk po kalon një sezon pozitiv në Superligën turke me skuadrën e Sivassporit. Sulmuesi ka shënuar vetëm katër gola në 12 ndeshje dhe tashmë po mendon për të ndryshuar ekip. Ai mund t'i japë lamtumirën Sivassporit pas një viti e gjysmë me këtë klub. Futbollisti kishte bërë të qartë se do të largohej gjithsesi në fund të sezonit kur i mbaron kontrata dhe në klub tashmë duan të përfitojnë nga një shitje e mundshme e tij. Kështu dyert për Manajn janë të hapura me një ofertë bindëse dhe mediet turke kanë bërë me dije se një nga klubet e mëdha të Turqisë, Trabzonspor, pritet t'i plotësojë kërkesat ekonomike për palët e përfshira. Skuadra e Trabzonsporit aktualisht nuk po bën mirë dhe ndodhet larg zonës së Evropës, ndaj po kërkojnë përforsime të rëndësishme për ringritjen e saj në pjesën e dytë të edicionit, me Manajn që shihet si një nga emrat që do ta ndihmojë për ta bërë kthesën. Vetë lojtari kishte deklaruar pak javë më parë se shihte veten gati për ta dhënë kontributin në një nga katër klubet kryesore turke, si Galatasaray, Fenerbahçe, Beshiktash dhe Trabzonspor.

Salah: Titulli? Duhet të qëndrojmë të përlur

Ylli egjiptian Mohamed Salah beson se Liverpooli po bën hapa drejt titullit të Premierë Ligës. Pas fitores 3-1 ndaj Leicester City të enjten mbrëma, klubi nga "Merseyside" tani është shtatë pikë larg në krye të tabelës dhe me një ndeshje më pak. Salah, i cili shënoi golin e tretë të Liverpoolit, foli për gazetarët pas ndeshjes teksa dha një këshill për ekipin. "Gara për titull ndihet ndryshe... por gjëja më e rëndësishme është që ne duhet të qëndrojmë të përlur", ka deklaruar Salah. Ndryshe, Arne Slot ka bërë jashtëzakonisht mirë që kur mori drejtimin e Liverpoolit, me 13 fitore, tri barazime dhe vetëm një humbje në 17 ndeshje të Ligës Premierë deri më tani. Në anën tjetër, Salah ka vazhduar shkëlqimin me 16 gola dhe 11 asistime në kampionat apo 19 gola e 15 asistime në të gjitha garat.

Verstappeni: Ja çfarë do të bëj pas largimit nga Formula 1

Piloti holandez Max Verstappen fitoi këtë vit titullin e katërt kampion bote për pilotë në Formula 1. Tashmë 27 vjeç, piloti i Red Bullit mendon edhe për të ardhmen e tij, atë të ardhme jashtë botës së Formulës 1. Verstappen shprehet se dëshiron të fokusohet më shumë në disa gara individuale sesa në vetë kampionatet, të tilla si WEC ose IMSA. "Pas F1 unë absolutisht dua të bëj garat 'endurance', të gjitha 24 orët dhe garat më të rëndësishme", ka thënë Verstappen. "Natyrisht që dua t'i shijoj ato, por nuk është vetëm kjo. Unë jam mësuar të garoj për fitore dhe këtë gjë do të bëj edhe në të ardhmen. Kështu që unë nuk do t'i bëja këto gara vetëm për argëtim. Dua të përpiqem të fitoj", ka shtuar Verstappen. Duket se holandezi e ka të qartë se dëshiron të kurorëzohet fitues në gara legjendare si Daytona, Spa, Nurburgring si dhe padyshim Le Mans. Verstappen ka kontratë me Red Bullin deri në fund të sezonit 2028.

Amorim: Po përjetojmë një çast të vështirë

Manchester Unitedi zhytet thellë në krizë. Skuadra e portugezit Ruben Amorim nuk sheh dritë jeshile, në fund të tunelit, ku ka hyrë

prej javësh e nuk po arrin të dalë dot më. Një humbje që e lë Unitedin shumë prapa në renditje, teksa aktualisht është renditur në vendin e 14

me 22 pikë, ndërsa tekniku Amorim e ka të vështirë ta fshehë zhgënjimin pas një tjetër humbje të ekipit të tij. "Po përjetojmë një moment

të vështirë dhe nuk e dimë se sa do të zgjasë. Ajo që duhet të bëjmë është të fokusohemi te ndeshja e radhës. Nuk e kam idenë se

kur mund të dalim nga kjo krizë. Duhet të fokusohemi e të stërvitemi çdo ditë për ta tejkaluar këtë çast", ka thënë Amorim.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Cje Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Nestate” SH.P.K. me seli në Gjakovë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812070382 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Nestate” D.O.O. Gjakove, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812070382 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Nestate” L.L.C. with headquarters Gjakovë, has come to the decision to quit its business: 812070382 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Labinot Haziri nga Prishtina shpall të pavlefshme dëftesat si dhe diplomën e Gjimnazit “Eqrem Çabej” Prishtinë.

Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

Ardian Bozhegu nga Gjakova shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit “Ardian Pozhegu” B.I. Me nrb: 810244012.

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

Blenda Gashi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë “Hysni Zajmi”.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

Lumë's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lumë's Details

lumescdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992

